

Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve Sha
Kompania

PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	1
Pasqyra e pozicionit finansiar	3
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	5
Pasqyra e rrjedhës së parasë	6
Shënime për pasqyrat financiare	7-23

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e "Fondi Slloveni Kosovar i Pensioneve Sh.a"

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondi Slloveni Kosovar I Pensioneve Sh.a ("Kompania"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit finanziar me datën 31 dhjetor 2018, Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të Kompanis më 31 dhjetor 2018 dhe performancën e saj financiare për vitin e përfunduar me këtë datë, në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë pérshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEK) që janë relevante në auditimin tonë të pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës. Ne kemi përbushur përgjegjësitë tona tjera në pajtim me Kodin BSNEK.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Kompanis më dhe për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017, janë audituar nga një auditor tjetër, i cili shprehu një opinion të pakulifikuar për këto pasqyra financiare më 21 Shkurt 2018.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Përsonave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontolle të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësishnë e Kompanisë për të kryer veprimtarinë në vijmësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështje që kanë të bëjnë me vijushmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatoshme, perveq rasteve kur menaxhmenti synon të ndërpres aktivitetin, ose nuk ka alternative tjetër reale përvëq se më sipër.

Personat e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një gabim materiale kur ai ekziston. Gabimet mund të vijnë si rezultat i gabimit apo i pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe ruajmë skepticizm profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, si rezultati i mashtrimeve apo pasaktësive, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të një gabimi si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i mosbulimit të një gabimi si pasojë e paskatësis, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë një marvseshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, keqinterpretim, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- marrim një kuptueshmëri të atyre kontolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontolleve të brendshme të Kompanisë.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlersimeve kontabël, si dhe shënimëve shpjeguese të pregaditura nga Menaxhmenti.
- Japim përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimitarës të perdonur nga Menxhmenti dhe bazuar në evidencat e siguruara të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale mbi aftësinë e Kompanisë për të vijuar veprimitarinë. Në rast se arrijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të térheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkates, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona janë të bazuara në evidencat e siguruara të auditimit të marra deri ne ditën e lëshimit të raportit të auditorit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijëmsisë së veprimitarës së Kompanisë.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimëve shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.


Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e kompanisë, ndërmjet të tjera, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuarë të auditimit si dhe gjeljet e rëndësishme të konstatuara gjatë auditimit, përfshirë mangsitë e rëndësishme në sistemin e kontrollave të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

RSM Kosovo Sh.p.k

RSM Kosovo Sh.p.k

Prishtinë, Kosovë

22 Shkurt 2019



Astrit Kelmendi

Partner i angazhimit

Ky raport është përkthim i versionit original në gjuhën angleze, në rast të mospërputhjeve midis këtyre raporteve, rapporti në gjuhën angleze do të mbizotrojë

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING

RSM Kosovo Sh.p.k is a member of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.


**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

Më 31 Dhjetor 2018

(Vlerat në Euro, përvèç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	Më 31 Dhjetor 2018	Më 31 Dhjetor 2017
PASURITË			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	19,954	56,643
Pasuritë financiare të mbajtura sipas vlerës së drejtë nepërmjetë të ardhurave tjera gjithpërfsirëse (FVOCI)	5	397,368	-
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	5	-	437,571
Prona dhe pajisje	6	7,276	4,603
Llogaritë e arkëtueshme dhe pasuritë e tjera	7	18,679	25,307
Parapagimi i tatimit në fitim		1,442	-
GJITHSEJ PASURITË		444,719	524,124
DETYSIMET			
Detyrimet tregtare dhe të tjera	8	12,331	13,000
Detyrimet e lizingut finanziar	9	299	3,680
GJITHSEJ DETYSIMET		12,630	16,680
EKUITETI			
Kapitali aksionar	10	400,000	400,000
Rezerva e rivlerësimit		7,338	13,827
Fitimi/Humbja e akumuluar		24,751	93,617
GJITHSEJ EKUITETI		432,089	507,444
GJITHSEJ DETYSIMET DHE EKUITETI		444,719	524,124

Këto pasqyra financiare janë aprovar nga Bordi Menaxhues i Fondit Slovano Kosovar i Pensioneve Sh.a – më 31 Janar 2019 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga



Z. Bajram Bajrami,
Drejtor Menaxhues

Shënimet plotësuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE**
Më 31 Dhjetor 2018

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	2018	2017
TË HYRAT			
Tarifa e menaxhmentit për Fondin 1		105,098	101,879
Tarifa e menaxhmentit për Fondin 2		6,189	9,133
Tarifa hyrëse		15,341	14,927
Tarifa e daljes		4,551	6,277
Të hyrat nga interesë	11	12,258	16,228
TË HYRAT NETO		143,437	148,444
 SHPENZIMET			
Shpenzimet operative	12	(119,419)	(118,814)
Shpenzimet e interesit		(229)	(562)
Zhvlerësimi		(205)	-
GJITHSEJ SHPENZIME		(119,853)	(119,376)
 Fitimi para tatimit		23,584	29,068
Shpenzimet e tatimit mbi fitim	13	(2,450)	(2,999)
Fitimi për vitin		21,134	26,069
 Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Zërat që mund të riklasifikohen si fitim ose humbje			
Ndryshimi neto në vlerën e tregut të pasurisë financiare, të mbajtura sipas vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave tjera gjithpëfshirëse (FVOCI)		(6,489)	(12,581)
GJITHSEJ TË ARDHURA GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN		14,645	13,488

Shënimet plotësuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET**

Më 31 Dhjetor 2018

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Kapitali Aksionar	Rivlerësimi i rezervës për letra me vlerë	Fitime të pashpërndara	Gjithsej
Gjendja më 1 JANAR 2018	400,000	13,827	93,617	507,444
Transaksione me pronarin				
Dividentat	-	-	(90,000)	(90,000)
Gjithsej transaksione me pronarin	-	-	(90,000)	(90,000)
Fitimi për vitin	-	-	21,134	21,134
Humbje tjetër gjithëpërfshirëse	-	(6,489)	-	(6,489)
GJITHSEJ TË ARDHURAT (HUMBJET) GJITHËPËRFSHIRËSE		(6,489)	21,134	14,645
Gjendja më 31 DHJETOR 2017	400,000	7,338	24,751	432,089
Gjendja më 1 JANAR 2017	400,000	26,408	67,548	493,956
Transaksione me pronarin				
Dividentat e deklaruara	-	-	-	-
Gjithsej transaksione me pronarin	-	-	-	-
Fitimi për vitin	-	-	26,069	26,069
Humbje tjetër gjithëpërfshirëse	-	(12,581)	-	(12,581)
GJITHSEJ TË ARDHURA GJITHËPËRFSHIRËSE		(12,581)	26,069	13,488
Gjendja më 31 DHJETOR 2017	400,000	13,827	93,617	507,444

Shënimet plotësuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	2018	2017
AKTIVITETET OPERATIVE			
Fitimi para tatimit në fitim		23,584	29,068
Rregulluar për:			
Zhvlerësim dhe amortizim		4,594	3,706
Të hyrat nga interesit		(12,258)	(16,321)
Shpenzimet e interesit		229	883
Zhvlerësimet		205	-
<i>Të ardhurat operative para ndryshimeve në pasurinë operative</i>		16,354	17,336
Ndryshimet në kapitalin e punues:			
Llogaritë e arkëtueshme dhe pasuri të tjera		3,234	1,119
Detyrimet tregtare dhe të tjera		2,331	2,095
Interesi i pranuar		14,858	16,023
Interesi i paguar		(229)	(883)
Tatimi në të ardhura i paguar		(3,438)	-
<i>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative</i>		33,110	35,690
AKTIVITETET INVESTUESE			
Ndryshime në investime te mbajtura sipas vleres se drejtë nepermjet te ardhurave tjera gjithperfshirese (FVOCI)		30,850	(34,861)
Blerja e pronës dhe pajisjeve		(7,267)	-
<i>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet investuese</i>		23,583	(34,861)
AKTIVITETET FINANCUESE			
Dividentat e paguara		(90,000)	-
Detyrimet ndaj lizingut financiar		(3,382)	-
<i>Paraja e përdorur në aktivitetet financuese</i>		(93,382)	-
NDRYSHIMI NETO NË PARA DHE EKUIVALENTËT E SAJ			
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të periudhës		56,643	55,814
PARAJA DHE EKUIVALENTËT E SAJ NË FUND TË PERIUDHËS	4	19,954	56,643

Shënimet plotësuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

(Vlerat në Euro, përvèç nëse theksohet ndryshe)

1. Informacione të përgjithshme

Fondi i Slloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a. (më tutje referuar si "Shoqëria" ose "FSKP") është themeluar si shoqëri aksionare më 29 Gusht 2006 me numër regjistrimi të biznesit 70378739. Shoqëria ka filluar veprimitarinë e saj më 4 Shtator 2006. Zyra e regjistruar ndodhet në Rr. Ukshin Hoti, nr.45/10, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Aksionarët kryesorë të Shoqërisë janë Prva Group PLC, e cila është themeluar në Slloveni me pronësi të 67.4% të aksioneve dhe Korporata Dukagjini në Kosovë me 32.6% të aksioneve. Kompania e fundit amë është kompania sllovene A-Z Finance d.o.o.

Veprimitaritë kryesore e Shoqërisë janë si në vijim: menaxhimi i fondeve pensionale, përfaqësimi i tyre para palëve të treta dhe të gjitha aktivitetet e tjera të lidhura me fondet e pensioneve.

Që nga fillimi i saj e deri në fillim të vitit 2008, Shoqëria ka menaxhuar një fond pensional vullnetar (më tutje referuar si "Fondi 1"). Gjatë vitit të përfunduar më 31 Dhjetor 2008, Shoqëria ka nënshkruar marrëveshje me shoqërinë me PTK fondin në likuidim të sigurimit pensional plotësues (më tutje referuar si "PTK"), për menaxhimin të pasurive të tyre dhe pagesën e pensionit vjetor në çdo muaj sipas planeve të paracaktuara të pensioneve të ofruar nga PTK. Pasuritë e PTK përbëjnë fondin e dytë pensional nën menaxhimin e FSKP (më tutje referuar si "Fondi 2 dhe gjithashu kontribuesit e transferuar nga Fondi 1 pas moshës së pensionit).

2. Politikat e Rëndësishme Kontabël

Politikat kryesore kontabël të miratuara për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha vitet e paraqitura, përvèç nëse është theksuar ndryshe.

Bazat e Përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijueshmërisë.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke përdorur politikat e rëndësishme të kontabilitetit dhe bazat e matjes të përbledhura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e paraqitura, përvèç nëse caktohet ndryshe.

Këto pasqyra financiare duhet të lexohen ashtu siç janë përgatitur në përputhshmëri me standardet dhe rregulloret kontabël Gjithashu, kërkon që menaxhmenti të vlerësojë procesin e zbatimit të politikave kontabël.

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro, monedha e Bashkimit Evropian.

Standardet dhe Interpretimet efektive në periudhën aktuale

Shoqëria ka miratuar të gjitha Standardet dhe Interpretimet e reja ose të ndryshuara të Kontabilitetit të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") të cilat janë efektive për periudhën raportuese aktuale.

Çdo standard i ri ose i ndryshuar i kontabilitetit që nuk është ende i obligueshëm nuk është implementuar menjëherë. Standardet dhe Interpretimet më të rëndësishme për Shoqërinë janë paraqitur në vijim:

- SNRF 9 është miratuar pa e riparaqitur informacionin krahasues. Prandaj, riklasifikimet dhe rregullimet që rrjedhin nga rregullat e reja të zhvlerësimit nuk pasqyrohen në bilancin e ripunuar më 31 Dhjetor 2017, por njihen në bilancin fillestar më 1 Janar 2018. Rregullimi i përgjithshëm i miratimit të SNRF 9 mbi Shoqërinë më 1 Janar 2018, është 205 Euro, i cili rrjedh si rezultat i lejimeve të zhvlerësimit të pasurive financiare me vlerë të tregut, nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.
- Më 1 Janar 2018 (data e zbatimit fillestar të SNRF 9), menaxhmenti i Shoqërisë ka vlerësuar se cilat modele të biznesit zbatohen për pasuritë financiare të mbajtura nga Shoqëria dhe ka klasifikuar instrumentet e sajë financiare në kategoritë e duhura të SNRF 9. SNRF 9 nuk rezultoi të ketë ndryshuar në matjen e pasurive financiare, vetëm në riklasifikim në kategoritë e pasurive financiare. Efektet kryesore që rezultojnë nga ky riklasifikim janë si më poshtë:

FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIJA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

(Vlerat në Euro, përvèç nëse theksohet ndryshe)

2. Politikat e Rëndësishme Kontabël (Vazhdim)

Pasuritë Financiare	Në Dispozicion për shitje	Vlera e drejtë përmes të ardhurës tjetër gjithëpërfshirëse
Bilanci përbyllës 31 Dhjetor 2017 – IAS 39	417,994	-
Transferi nga kategoria shitjet në dispozicion në vlerë të tregut përmes të ardhurës tjetër gjithëpërfshirëse	(417,994)	417,994
Transferi nga mbajtur deri në maturim në pasuri financiare me kosto të amortizuar		
Bilanci hapës më 1 Janar 2018 para ndryshimit për zhvlerësim		417,994

Standardet dhe Interpretimet e lëshuara por ende jo efektive

Standardet e Kontabilitetit të lëshuara ose ndryshuara së fundi por që ende nuk janë efektive, nuk janë miratuar menjëherë nga Shoqëria në periudhën vjetore raportuese të përfunduar më 31 Dhjetor 2018. Vlerësimi i Shoqërisë lidhur me ndikimin e këtyre Standardeve dhe Interpretimeve të reja ose ndryshuara të Kontabilitetit, më të rëndësishmeve për Shoqërinë, janë paraqitur më poshtë.

- SNRF 16 është lëshuar në Janar të vitit 2016. Kjo do të rezultojë në pothuajse të gjitha qiratë të njihen në bilanc nga qiramarrësit, pasi dallimi në mes qirasë operative dhe financiare të hiqet. Sipas standardeve të reja, është bërë njohja e pasurisë (së drejtës për përdorim të artikullit të lëshuar me qira) dhe detyrimit financier për të paguar qiratë. Përjashtimet e vetme janë qiratë afatshkurtra dhe me vlerë të vogël. Shoqëria ka një kontratë qiraje për hapësirë të zyrës. Shoqëria pret të njohë të Drejtën e Përdorimit të Pasurisë dhe Detyrimit të Qirasë në lidhje me marrëveshjen e qirasë në shumë prej 21,583 Euro. Marrëveshjet e qirasë kanë afatin e maturimit deri në 31 Mars 2020, me mundësi vazhdimi për tre vite të tjera dhe mundësia është marrë në konsideratë për t'u ushtruar në llogaritjen e vlerës kontabël të së drejtës për përdorim të pasurive dhe detyrimeve të qirasë.

Pasuritë Financiare

Klasifikimi

Nga 1 Janari 2018, Shoqëria ka klasifikuar pasuritë e saj financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes:

- ato që duhet matur më pastaj me vlerë të tregut (qoftë përmes OCI ose përmes fitimit ose humbjes), dhe
- ato që duhet matur me kosto të amortizuar.

Klasifikimi varet nga modeli i biznesit të njësisë ekonomike për menaxhim të pasurive financiare dhe kushteve kontraktuale të rrjedhës së parasë.

Shoqëria riklasifikon investimet e borxhit atëherë dhe vetëm atëherë kur ndryshon modeli i saj i biznesit për menaxhimin e këtyre pasurive.

Njohja dhe mosnjohja

Blerjet dhe shitjet e irregullta të pasurive financiare njihen në datën e tregtimit, datën në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë ose shet pasurinë. Mosnjohja e pasurive financiare atëherë kur të drejtat për të pranuar rrjedhën e parasë nga pasuritë financiare ka skaduar ose ato janë transferuar dhe Shoqëria kryesisht ka transferuar të gjitha rreziqet dhe të drejtës së pronësisë.

Matja

Gjatë njohjes fillestare, Shoqëria matë një pasuri financiare me vlerë të saj të tregut plus, në rastin e një pasurie financiare me vlerë jo të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVPL), kostot e transaksionit të ndërlidhura drejtpërdrejt me blerjen e pasurisë financiare. Kostot e transaksionit të pasurive financiare të mbajtura në FVPL janë shpenzuar në fitim ose humbje.

Pasuritë financiare me derivativat e lidhur merren në konsideratë si tërësi, për të përcaktuar nëse rrjedhën e tyre të parasë e përbëjnë vetëm pagesa e kryegjësë dhe interesit.

FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

(Vlerat në Euro, përvèç nëse theksohet ndryshe)

2. Politikat e Rëndësishme Kontabël (Vazhdimi)

Instrumentet e borxhit

Matja e mëpasshme e instrumenteve të borxhit varet nga modeli i biznesit i Shoqërisë për menaxhimin e pasurisë dhe karakteristikat e rrjedhjes së parasë së pasurisë. Ekzistojnë tre kategori të matjes, përmes së cilave Shoqëria i klasifikon instrumentet e saj të borxhit:

- Kostoja e amortizuar: Mjetet e mbajtura për grumbullimin e rrjedhës së parasë kontraktuale, atëherë kur këto flukse të parasë përfaqësojnë vetëm pagesat e kryegjësë dhe interesit, janë matur me koston e amortizuar. E hyra nga interesit nga këto pasuri financiare përfshihet në të hyrat financiare përmes metodës së normës efektive të interesit. Çdo fitim ose humbje që vjen si pasojë e mosnjohjes njihet direkt në fitim ose humbje dhe paraqitet në fitime / humbje të tjera së bashku me fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutor. Humbjet nga zhvlerësimi janë paraqitur si zë i veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Më 31 Dhjetor 2018, të arkëtueshmet për tarifën e menaxhimit janë klasifikuar në këtë kategori.
- FVOCI: Pasuritë e mbajtura për grumbullimin e rrjedhës së parasë kontraktuale dhe për shitjen e pasurive financiare, ku flukset e parasë së pasurive përfaqësojnë vetëm pagesat e kryegjësë dhe të interesit, janë matur përmes FVOCI. Lëvizjet në vlerën bartëse janë marrë përmes OCI, duke përjashtuar njohjen e fitimeve ose humbjeve nga zhvlerësimi, të ardhurat nga interesit dhe fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutor të cilat regjistrohen në fitim ose humbje. Mosnjohja e pasurisë financiare ndodh atëherë kur fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në OCI riklasifikohen nga ekuiteti në fitim ose humbje dhe regjistrohet tek fitimet/ (humbjet) e tjera. Të ardhurat nga këto pasuri financiare përfshihen në të ardhurat financiare duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutor paraqitet në fitime / (humbje) dhe shpenzimet e zhvlerësimit regjistrohet si zëri i veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Më 31 Dhjetor 2018 pasuritë financiare me vlerë të tregut nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, janë klasifikuar në këtë kategori.
- FVPL: Pasuritë që nuk plotësojnë kriteret për koston e amortizuar ose FVOCI janë matur përmes FVPL. Fitimi ose humbja e një investimi borxhi i cili matet më pastaj përmes FVPL, regjistrohet në fitim ose humbje dhe paraqitet përbrenda fitimeve / (humbjeve) të periudhës kur ato lindin. Më 31 Dhjetor 2018 pasuritë financiare me vlerë të tregut përmes fitimit dhe humbjes janë klasifikuar në këtë kategori.

Instrumentet e ekuitetit

Shoqëria më pastaj ka matur të gjitha investimet e kapitalit neto me vlerën e tregut. Atëherë kur menaxhmenti i Shoqërisë ka përzgjedhur që të paraqesë fitimet dhe humbjet sipas vlerës së tregut në investimet e kapitalit në OCI, nuk ka pasur riklasifikim të mëvonshëm të fitimeve ose humbjeve sipas vlerës së tregut në fitim ose humbje pas çregjistrimit të investimit. Dividentat nga investimet e tillë vazhdojnë të njihen në fitim ose humbje si të ardhura nga dividentat kur vendoset e drejta e Shoqërisë për të marrë pagesa.

Ndryshimet në vlerën e tregut të pasurive financiare në FVPL njihen në ndryshimet neto në vlerën e tregut të pasurive financiare me vlerë të tregut, nëpërmjet fitimit ose humbjes në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas rastit. Humbjet nga zhvlerësimi (dhe anulimi i humbjeve nga zhvlerësimi) për investimet e kapitalit të matura në FVOCI nuk raportohen veçmas nga ndryshimet e tjera në vlerën e tregut.

Zhvlerësimi

Nga 1 Janari 2018, Shoqëria vlerëson në bazë të rezultateve të parashikuara humbjet e pritura të kreditit të ndërlidhura me instrumentet e saj të borxhit të bartura me koston e amortizuar. Metodologja e zhvlerësimit është aplikuar, varet mbi atë nëse ka pasur ndonjë rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë.

Politikat Kontabël të zbatuara deri më 31 Dhjetor 2017

Shoqëria ka aplikuar SNRF 9 në mënyrë retrospektive, por ka zgjedhur të mos riparaqes informacionin krahasues. Si rezultat, informacioni krahasues i ofruar vazhdon të illogaritet, në përputhje me politikën e mëparshme kontabël të Shoqërisë.

FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

(Vlerat në Euro, përvèç nëse theksohet ndryshe)

2. Politikat e Rëndësishme Kontabël (Vazhdimi)

Klasifikimi

Deri më 31 Dhjetor 2017, Shoqëria ka klasifikuar pasuritë e saj financiare në kategoritë e mëposhtme:

- Mbahen për tregtim
- Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme, dhe
- Investimet e mbajtura deri në maturim,
- Pasuritë financiare në dispozicion për shitje

Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin janë bërë investimet. Menaxhmenti ka përcaktuar klasifikimin e investimeve të tij gjatë njohjes fillestare dhe, në rastin e pasurive të klasifikuara si të mbajtura deri në maturim, ka rivlerësuar këtë përcaktim në fund të se cilës periudhë raportuese.

Riklasifikimi

Për riklasifikimin e pasurive financiare, ju lutem t'i referoheni tabelës në pjesën *Standardet dhe Interpretimet efektive në periudhën aktuale*.

Matja e mëpasshme

Matja gjatë njohjes fillestare nuk ka ndryshuar me miratimin e SNRF 9, shih në përshkrimin e mësipërm. Si vazhdimësi e njohjes fillestare, kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe investimet e mbajtura deri në maturim janë bartur me kosto të amortizuar përmes metodës efektive të interesit.

Pasuritë financiare në dispozicion për shitje dhe pasuritë financiare në FVPL më pas janë mbajtur me vlerën e tregut. Fitimet ose humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e tregut njiheshin si më poshtë:

Pasuritë financiare dhe pasuritë financiare të gatshme për shitje në FVPL më pas janë mbajtur me vlerë të tregut.

Fitimet ose humbjet rezultuar nga ndryshimet në vlerën e tregut janë njohur si në vazhdim:

- për pasuritë financiare në pasuritë financiare në vlerë të drejtë -me vlerën e tregut, në pasqyrë e të ardhurave dhe shpenzimeve tek linja ndryshimi neto në vleren e drejtë të pasurisë financiare, përmes pasqyrës së të ardhurave.
- për pasuritë financiare në dispozicion për shitje të cilat janë letra monetare me vlerë të shprehura në valutë të huaj - diferencat e konvertimit ndërlidhur me ndryshimet në koston e amortizuar të letrave me vlerë, janë njohur tek fitimi ose humbja dhe të tjera ndryshime në vlerën bartëse janë njohur tek të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse.

Atëherë kur u realizua shitja e letrave me vlerë të klasifikuara si në dispozicion për shitje, rregullimet e akumuluara të vlerës së tregut të njohura tek të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse u riklasifikuan në fitim ose humbje si fitim dhe humbje nga investimi në letra me vlerë.

Zhvlerësimi

Në fund të çdo periudhe raportuese, Shoqëria ka vlerësuar nëse ka pasur ndonjë dëshmi objektive mbi dëmtimin e ndonjë pasurie financiare ose grupi të pasurive financiare. Një pasuri financiare ose një grup e pasurive financiare është dëmtuar dhe humbjet nga dëmtimi janë kryer vetëm atëherë kur ekziston dëshmia objektive e zhvlerësimit si pasojë e një ose disa ngjarjeve të ndodhura pas njohjes fillestare të pasurisë (një 'rast humbjeje') dhe ai rast humbjeje (ose disa ngjarje) kanë pasur ndikim në rrjedhat e vlerësuara monetare të ardhshme të pasurisë financiare ose të grüpuit të pasurive financiare të cilat mund të vlerësohen me besueshmëri. Në rastin e investimeve të kapitalit të klasifikuar si në dispozicion për shitje, rënia e konsiderueshme ose e zgjatur në vlerën e tregut të letrave me vlerë nën koston e saj është vlerësuar si tregues i zhvlerësimit të pasurive.

Pasuritë e bartura në koston e amortizuar

Për kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme, shuma e humbjes është llogaritur si diferençë në mes vlerës së bartur të pasurisë dhe vlerës aktuale të flukseve të vlerësuara monetare të ardhshme (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kreditimit) e zbritur me normën fillestare efektive të interesit të pasurisë financiare. Vlera bartëse e pasurisë është zbritur dhe shuma e humbjes është njohur tek fitimi ose humbja. Nëse kredia ose investimi i mbajt deri në maturim do të kishte normë të ndryshueshme të interesit, norma e skontimit për matjen e çfarëdo humbje nga zhvlerësimi aktuale përfaqësohet me normën efektive të interesit sipas kontratës. Si një praktike e përshtatshme, Shoqëria ka mundur të bëjë matjen e zhvlerësimit sipas bazës së vlerës së tregut të një instrumenti, përmes çmimit të vëzhgueshëm të tregut.

Në qoftë se, në një periudhë të mëvonshme, vlera e humbjes nga zhvlerësimi ka pësuar rënie dhe kjo rënie mund të ndërlidhet objektivisht me ngjarje që ndodhin pas njohjes së zhvlerësimit (sikurse mund të jetë përmirësimi në klasifikimin kreditorë të debitorit), humbja nga zhvlerësimi anullohet nëpërmjet fitimeve ose humbjeve.

**FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

(Vlerat në Euro, përvèç nëse theksohet ndryshe)

2. Politikat e Rëndësishme Kontabël (Vazhdimi)

Pasuritë e klasifikuara në dispozicion për shitje

Po që se ka ekzistuar ndonjë evidencë objektive e zhvlerësimit të pasurive financiare në dispozicion për shitje, humbja kumulative - e matur si diferenca mes kostos së blerjes dhe vlerës aktuale të tregut, zbritur humbjet nga zhvlerësimi i asaj pasurie financiare më parë të njojur në fitim ose humbje - është hequr nga kapitali duke u njojur në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi i instrumenteve të kapitalit të njoitura në fitim ose humbje, nuk janë anuluar përmes fitimit ose humbjes në periudhën pasuese. Nëse vlera e tregut e një instrumenti borxhi të klasifikuar në dispozicion për shitje ka pësuar rritje në periudhën pasuese dhe ajo rritje mund të ndërlidhet objektivisht me ngjarje që ndodhin pas njoftes së humbjes nga zhvlerësimi në fitim ose humbje, humbja nga zhvlerësimi anulohet përmes fitimit ose humbjes.

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Për qëllime investimi, paraja dhe ekuivalentët e saj, duke përfshirë bilancet me bankat për pagesa të kontributive pensionale janë bartur në shpenzime.

Të arkëtueshmet dhe detyrimet që lidhen me letrat me vlerë të investimit

Të arkëtueshmet dhe llogaritë e pagueshme lindin nga blerja dhe shitja e investimeve dhe njihen si pasuri dhe/ose detyrime në datën e kryerjes së transaksionit.

Prona dhe Pajisjet

Prona dhe pajisjet janë bartur në shpenzimet ose në kosto të vlerësuar minus zhvlerësimi i akumuluar.

Zhvlerësimi ngarkohet mbi një bazë lineare, në mënyrë që të alokohen kostot ose kostot e vlerësuara të pronës dhe pajisjeve mbi kohën e tyre të përdorimit. Në vazhdim janë paraqitur normat vjetore të përafërtë të amortizimit të aplikuara tek zërat e rëndësishëm të pronës dhe pajisjeve:

	Në datën e bilancit të gjendjes
Kompjuter	20%
Pajisjet tjera	20%
Pasuritë e patrupëzuara	20%

Blerjet pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të pasurisë apo janë njojur si pasuri të ndara, sipas rastit, vetëm kur ekziston mundësia e fluksit të përfitimeve ekonomike të ardhshme në Shqëri, lidhur me zërin dhe kur vlera e blerjes së pasurisë mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave si shpenzim i periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur ato.

Zhvlerësimi i pasurive jo financiare

Pasuritë të cilat janë subjekt i zhvlerësimit/amortizimit rishikohen për zhvlerësim kurdo që ngjarja ose ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera bartëse mund të mos jetë e rikuperueshme. Vlera bartëse e një pasurie shkruhet menjëherë në shumën e rikuperueshme, atëherë kur vlera bartëse e pasurisë është më e madhe se shuma e rikuperueshme e vlerës së saj. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë e vlerës së tregut të pasurisë, minus kostot e shitjes dhe vlera në përdorim.

Të hyrat nga interesi

Të hyrat nga interesi përfshijnë të ardhurat nga normat e kuponëve të obligacioneve dhe interesit mbi depozitat me afat. Të hyrat e interesit janë regjistruar në bazë akruale.

Të hyrat nga dividenta

Dividentat njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse atëherë kur përcaktohet e drejta e Fondit për të pranuar pagesën.

Tarifa e menaxhimit

Fondi 1 është i detyruar të paguajë tarifën e menaxhimit të Kompanisë në baza mujore. Tarifa vjetore e menaxhmentit është 1.5% e gjithsej pasurisë së Fondit 1.

Shpenzimet për tarifat e transaksionit

Këto shpenzime lidhen me tarifën e paguar ndërmjetësuesve finansiarë (bankave dhe komisionerëve) të cilët blejnë investime.

**FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politikat e rëndësishme kontabël (Vazhdimi)

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar përfaqëson vlerën nominale të aksioneve të emetuara.

Dividenda e aksioneve të zakonshme njihet në periudhën kur aprovohet nga aksionarët e Shoqërisë. Dividendët për vitin kur ato janë botuar, pas datës së bilancit, janë shpalosur në shënimin për ngjarjet e mëvonshme.

Fitimet / humbjet e realizuar

Fitimet/humbjet e realizuara dalin nga shitja e letrave me vlerë, nivelizimi i çmimeve kur letrat me vlerë janë siguruar dhe kapitali i maturuar dhe interesit për letrat me vlerë janë siguruar në prime ose zbritje. Këto fitime/humbje janë regjistruar në të ardhura ose shpenzime kur ato ndodhin.

Fitimet ose humbjet që rrjedhin atëherë kur investimet janë shitur ose kanë maturuar paraqiten si "të realizuara" në pasqyrën e të ardhurave, ndërkaq fitimet ose humbjet që vijnë nga vlerësimi i investimeve të mbajtura paraqiten veçmas si "të parealizuara" në ndryshimet neto në vlerën e tregut të pasurive financiare me vlerë të tregut, përmes fitimit ose humbjes.

Amortizimi i zbritjes/primi i letrës me vlerë

Amortizimi i diskontit/primit të letrës me vlerë është regjistruar përmes të ardhurave / shpenzimeve të shtyra dhe shpenzimeve/të ardhurave akruale. Në momentin kur letra me vlerë është maturuar apo shitur, shuma e amortizuar është transferuar si fitim ose humbje e realizuar kapitale.

Fitimet / humbja nga këmbimi valutor

Transaksionet në valutën e huaj janë regjistruar në pajtueshmëri me normat e vlefshme të këmbimit valutor në datën e transaksionit. Diferencat janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si fitime/humbje.

Diferencat e këmbimit valutor të cilat rrjedhin nga raportimi në datën e vlerësimit të parasë së gatshme dhe ekuivalentë të saj dhe diferencës që rrjedhë nga shitja e investimeve, raportohen ndaras në pasqyrën e të ardhurave si "të realizuara". Diferencat e këmbimit valutor të cilat rrjedhin nga raportimi në datën e përkthimit të investimeve të mbajtura, raportohen ndaras në pasqyrën e të ardhurave si "të parealizuara".

Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përkufizohen si ato palë të cilat kanë kontrollë mbi njëra tjetrën ose që mund të kenë ndikim në vendimet financiare dhe operacionale të njëra tjetres.

Palët e lidhura me Shoqërinë janë Prva Group PLC nga Lubjana, Slloveni dhe Korporata Dukagjini nga Peja, Republika e Kosovës, të cilët menaxhojnë dhe administrojnë Kompaninë 1 dhe Kompaninë.

Zotimet dhe kontingjencat

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen vetëm nëse mundësia e daljes së parasë që trupëzon përfitime ekonomike është e largët. Përveç kësaj, pasuria kontingjente nuk është njohur në pasqyrat financiare, por është shpalosur atëherë kur rrjedha e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Shuma e humbjes kontingjente njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do të konfirmojnë se një detyrim i shkaktuar në datën e pozicionit finanziar dhe se vlerësimi i arsyeshëm i shumës së humbjes së rezultuar mund të bëhet.

Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit të cilat ofrojnë informacion shtesë mbi pozicionin e Shoqërisë në datën e pozicionit finanziar (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat nuk janë ngjarje të rregulluara, janë shpalosur tek shënimet atëherë kur ato kanë qenë materiale.

FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

(Vlerat në Euro, përvèç nëse theksohet ndryshe)

3. Vlerësimet dhe supozimet kritike të kontabilitetit

Vlera e drejtë e letrave me vlerë të pa kuotuara në tregun aktiv

Vlera e drejtë e letrave me vlerë të tilla të pa kuotuara në një treg aktiv mund të përcaktohet nga Shoqëria duke përdorur burime të besueshme të çmimeve ose çmime treguese nga obligacionet/borxhet e tregut.

Shoqëria do të ushtrojë gjykimin dhe vlerësimet lidhur me sasinë dhe cilësinë e burimeve të çmimeve të përdorura. Kur nuk ka të dhëna në treg, Shoqëria mund të vë çmim për pozicionet e saj duke përdorur modelet e veta, të cilat zakonisht janë të bazuara në metoda të vlerësimit dhe teknikat të rishikuar të skontuara. Modelet e përdorura përfunduan më 31 dhjetor 2018. Shoqëria mund të vlerësimet e cilësive të burimeve të çmimeve të përdorura. Kur nuk ka të dhëna në treg, Shoqëria mund të vë çmim për pozicionet e saj duke përdorur modelet e veta, të cilat zakonisht janë të bazuara në metoda të vlerësimit dhe teknikat të rishikuar të skontuara. Modelet e përdorura përfunduan më 31 dhjetor 2018.

FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

(Vlerat në Euro, përvèç nëse theksohet ndryshe)

4. Paraja dhe Ekuivalentët e Saj

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Paraja e gatshme	282	199
Depozitat në Banka	19,672	56,444
GJITHSEJ PARAJA DHE EKUIVALENTËT E SAJ	19,954	56,643

5. Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes në pasqyrat e pozicioneve financiare janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Obligacionet e korporatave	149,019	118,293
Obligacionet qeveritare	245,354	313,477
Interesi i përllogaritur	3,200	5,801
Amortizimi i zbritjes	(205)	-
GJITHSEJ PASURITË FINANCIARE NË FVOCI	397,368	437,571

Më 31 Dhjetor 2017 këto investime u klasifikuan në kategorinë të disponueshme për shitje.

Për cilësinë e bonove dhe bonove të thesarit, referojuni shënimit 16 Menaxhimi i Riskut Financiar.

6. Prona dhe pajisjet

	Lizingu finanziar	Pajisje	Gjithsej
Shpenzime			
MË 01 JANAR 2017	17,500	91,780	109,280
Shtesat për vitin			
MË 31 DHJETOR 2017	17,500	91,780	109,280
 MË 01 JANAR 2018			
Shtesat për vitin	17,500	91,780	109,280
	-	7,267	7,267
MË 31 DHJETOR 2018	17,500	99,047	116,547
 ZHVLERËSIMI I AKUMULUAR			
Në 01 janar 2017	(10,208)	(90,763)	(100,971)
Zhvlerësimi për vitin	(3,500)	(206)	(3,706)
Më 31 Dhjetor 2017	(13,708)	(90,969)	(104,677)
 MË 01 JANAR 2018	 (13,708)	 (90,969)	 (104,677)
Zhvlerësimi për vitin	(3,500)	(1,094)	(4,594)
MË 31 DHJETOR 2018	(17,208)	(92,063)	(109,271)
 VLERA BARTËSE			
MË 31 DHJETOR 2017	3,792	811	4,603
MË 31 DHJETOR 2018	292	6,984	7,276

FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA

SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

(Vlerat në Euro, përvèç nëse theksohet ndryshe)

7. Të arkëtueshmet dhe pasuritë e tjera

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Tarifa e menaxhimit nga Fondi 1	8,686	9,133
Tarifa e menaxhimit nga Fondi 2	6,190	8,985
Të arkëtueshmet e tjera	50	-
Gjithsej tarifa e menaxhimit	14,926	18,118
Të arkëtueshmet nga tarifat hyrëse dhe dalëse	1,876	1,764
Parapagimet	1,877	2,032
Parapagimi tatimor	-	3,393
GJITHSEJ TË ARKËTUESHMET DHE PASURITË E TJERA	18,679	25,307

8. Detyrimet tregtare dhe të tjera

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Furnitorët	7,704	4,008
Detyrimet ndaj të punësuarve	1,980	-
Detyrimet ndaj fondit	590	657
Detyrimet për kontributin pensional dhe tatimin mbi të ardhurat personale	1,968	5,303
Detyrime ndaj tatimit në të ardhura	-	2,999
Të tjera	89	33
GJITHSEJ DETYRIME TREGTARE DHE TË TJERA	12,331	13,000

9. Detyrimet e lizingut finanziar

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Detyrimi ndaj lizingut afatgjati ndaj lizingut afatgjatë	-	3,680
Minus: maturiteti aktual	-	(3,048)
Mbajtja e interesit afatgjatë për lizing	-	632
Maturiteti aktual i lizingut afatgjatë		
Lizingu afatshkurtër	299	3,048
GJITHSEJ DETYRIMET E LIZINGUT FINANCIAR	299	3,680

10. Kapitali aksionar

Më 31 Dhjetor 2018, sipas librit të aksionarëve në pasqyrën e pozitës financiare, vlera totale e kapitalit aksionar është 400,000 Euro (31 Dhjetor 2016: 400,000 Euro).

Struktura e kapitalit aksionar të Shqërisë sipas librit të aksionarëve më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 është si në vazhdim:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Prva Group PLC, Slloveni	67.40%	67.40%
Dukagjini sh.p.k, Republika e Kosovës	32.60%	32.60%
100%	100%	100%

**FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

11. Të hyrat nga interesit

	2018	2017
Të ardhurat nga investimet në FVOCI	12,258	16,228
GJITHSEJ TË HYRAT NGA INTERESI	12,258	16,228

12. Shpenzimet Operative

	2018	2017
Pagat dhe shpenzimet e tjera të personelit	64,551	63,941
Shpenzimet për operacionet e biznesit	5,400	5,400
Tarifat e BQK-së dhe shërbimet financiare	14,076	13,310
Shpenzimet administrative	14,782	16,970
Amortizimi	4,594	3,706
Shpenzime të qirasë	5,400	5,250
Shpenzime të telefonit	1,957	1,896
Shpenzime të karburantit	2,176	1,970
Tarifat bankare	1,496	1,205
Tatimet (interesi, qiraja)	1,493	1,394
Shpenzime të tjera	3,494	3,772
GJITHSEJ SHPENZIMET OPERATIVE	119,419	118,814

13. Shpenzimet e tatimit mbi të ardhura

	2018	2017
Fitimi para tatimit	23,584	29,068
Tatimi në shkallën prej 10%	2,358	2,907
Korrigjuar përfshinë tatimore në:	-	-
Shpenzimet e pa lejueshme për qëllime tatimore	92	92
Të ardhurat e pa tatushme për qëllime tatimore	-	-
Humbjet tatimore të bartura	-	-
Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat për vitin	2,450	2,999

14. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e ndërlidhura përfshijnë aksionerët kryesorë të Kompanisë, filialat dhe entitetet nën pronësi të përbashkët, kontrolli dhe menaxhimi i përbashkët i Shoqërisë, ose aktivitetet mbi të cilat Shoqëria ka aftësi për ushtruar kontrollë.

Të gjitha transaksionet e Shoqërisë me palët e lidhura dalin nga rrjedha normale e biznesit dhe vlera e tyre nuk është materialisht e ndryshme nga afatet dhe kushtet që do të zotëronin në transaksione të vullnetit të lirë.

Të gjitha transaksionet dhe bilancet e palëve të lidhura dhe balancet i referohen Shoqërisë, FSKP-së dhe menaxherit të pasurive, dhe janë si në vijim:

FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA

SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

31 Dhjetor 2018	Kompania Prva	Fondi 1	Fondi 2	Menaxhmenti Kyç	Gjithsej
Të arkëtueshmet nga tarifa e menaxhimit	-	8,686	6,190	-	14,876
Të arkëtueshmet nga tarifat dalëse	-	162	-	-	162
Të arkëtueshme nga tarifat hyrëse	-	1,714	-	-	1,714
Të arkëtueshmet tjera	-		50	-	50
Gjithsej të arkëtueshmet		10,562	6,240	-	16,802
 Detyrimet					
Detyrimet	-	(360)	(230)	-	(590)
Gjithsej detyrimet	-	(360)	(230)	-	(590)
 Neto të arkëtueshmet		10,202	6,010		16,212
 Të hyrat nga tarifat hyrëse		15,341	-	-	15,341
Të hyrat nga pagesa e daljes		4,551	-	-	4,551
Të hyrat nga tarifa e menaxhimit		105,098	6,189	-	111,287
Gjithsej të hyrat		124,989	6,189		131,179
 Shpenzimet					
Shpenzimet për operim të biznesit	(5,400)	-	-	-	(5,400)
Shpenzimet për TI	(2,400)	-	-	-	(2,400)
Shërbimet e softuerit	(4,200)	-	-	-	(4,200)
Pagat dhe shpenzimet e tjera	-	-	-	(28,135)	(28,135)
Gjithsej shpenzimet	(12,000)			(28,135)	(40,135)
 Të ardhurat / (shpenzimet)	(12,000)	124,989	6,189	(28,135)	91,043
31 Dhjetor 2017	Kompania Prva	Fondi 1	Fondi 2	Menaxhment i Kyç	Gjithsej
Të arkëtueshmet nga tarifa e menaxhimit	-	8,985	9,133	-	18,118
Të arkëtueshme nga tarifat dalëse	-	101	-	-	101
Të arkëtueshmet nga tarifat hyrëse	-	1,663	-	-	1,663
Gjithsej të arkëtueshmet	-	10,749	9,133		19,882
 Detyrimet					
Detyrimet	-	(387)	(270)	-	(657)
Gjithsej detyrimet	-	(387)	(270)	-	(657)
 Neto të arkëtueshmet / (detyrimet)	-	10,362	8,863	-	19,225

FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

Të hyrat nga tarifat hyrëse	14,927	-	-	14,927
Të hyrat nga tarifat dalëse	6,277	-	-	6,277
Të ardhura nga tarifa e menaxhimit	101,879	9,133	-	111,012
Gjithsej të hyrat	123,084	9,133	-	
<hr/>				
Shpenzimet				
Shpenzimet për operimin e biznesit	(5,400)	-	-	(5,400)
Shpenzimet për TI	(2,400)	-	-	(2,400)
Shërbimet e softuerit	(4,200)	-	-	(4,200)
Pagat dhe shpenzimet tjera	-	-	-	(34,310)
Gjithsej shpenzime	(12,000)	-	-	(34,310)
Neto të hyrat / (shpenzimet)	(12,000)	123,084	9,133	(34,310)
				85,906

FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

(Vlerat në Euro, përvèç nëse theksohet ndryshe)

15. Instrumentet financiare sipas kategorisë

Vlerat bartëse të pasurive financiare dhe detyrimeve të Shoqërisë siç janë njohur në datën e pasqyrave të pozicionit financier nën rishikim munden gjithashtu të kategorizohen si në vazhdim:

	Në vlerën e drejtë përmes të hyrave tjera gjithëpërfshirëse	Me kosto të amortizuar	Gjithsej
31 Dhjetor 2018			
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	19,954	19,954
Pasuritë Financiare te mbajtura sipas vleres se drejtë nepermjet te ardhurave tjera gjithperfshirese	397,368	-	397,368
GJITHSEJ PASURITË FINANCIARE	397,368	19,954	417,322

	Detyrime të tjera financiare		
Detyrimet			
Furnitorët	-	7,704	7,704
Detyrimet e lizingut	229	229	229
GJITHSEJ DETYRIMET FINANCIARE	-	7,913	7,913

	Në vlerën e drejtë përmes të hyrave tjera gjithëpërfshirëse	Me kosto të amortizuar	Gjithsej
31 Dhjetor 2017			
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	56,643	56,643
Pasuritë financiare në dispozicion për shitje	437,571	-	437,571
GJITHSEJ PASURITË FINANCIARE	437,571	56,643	494,214

	Detyrimet tjera financiare		
Detyrimet			
Furnitorët	-	4,008	4,008
GJITHSEJ DETYRIMET FINANCIARE	-	4,008	4,008

16. Menaxhimi i riskut financier

Aktivitetet e Shoqërisë janë të ekspozuara ndaj një shumëlojshmërie të risqeve financiare dhe këto aktivitete përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e risqeve. Qëllimi i Shoqërisë është që të arrihet një balancë e përshtatshme në mes të rrezikut dhe kthimit për të minimizuar efektet e mundshme negative mbi punën financiare të Shoqërisë.

Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë janë të dizajnuara për të identifikuar dhe analizuar këto rreziqe, për të vendosur limitet dhe kontrollot e duhura të riskut dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve nepërmjet sistemeve të besueshme dhe të përditësuar të informacionit. Menaxhmenti i Shoqërisë rregullisht rishikon politikat e saj të menaxhimit të riskut dhe sistemet për të pasqyruar ndryshimet në tregje, produkte dhe praktikat më të mira në zhvillim.

Menaxhimi i rrezikut kryhet nga departamenti i menaxhimit të riskut së Shoqërisë, sipas politikave të miratuara nga ajo. Ky departament identifikon dhe vlerëson rreziqet financiare në bashkëpunim të ngushtë me njësitë operative të Shoqërisë. Shoqëria siguron politika dhe procedura të shkruara për menaxhimin e riskut të përgjithshëm, si dhe politika të shkruara të cilat mbulojnë fusha specifike, të tillë sikurse risku i kursit të këmbimit, rreziku i normës së interesit dhe riscu kreditor.

**FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

(Vlerat në Euro, përvèç nëse theksohet ndryshe)

16. Menaxhimi i riskut finanziar (Vazhdimi)

Risku kreditor

Pasuritë financiare me vlerë të tregut nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Fondi merr pjesë në ekspozimin ndaj riskut kreditor, i cili paraqet rrezikun që një palë e kundërt të shkaktojë një humbje financiare për Fondin, duke dështuar në shlyerjen e një obligimi. Risku kreditor është risku më i rendësishëm për aktivitetet biznesore të Shoqërisë. Prandaj, menaxhmenti i Fondit me kujdes menaxhon ekspozimin ndaj riskut kreditor. Fondi duhet të jetë në përputhje me rregullat e BQK-së përsa i përket llojeve dhe shumave të investimeve në pasuritë financiare.

Lejimi i humbjeve nga investimi i aseteve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave më 31 Dhjetor 2017 bashkërendohet me lejimin për humbjet hyrëse më 1 janar 2018 dhe me lejimet për humbjen më 31 Dhjetor 2018 si vijon:

Kompensimet për dëmtime	2018
Lejimii i humbjeve më 31 Dhjetor 2017 (ilogaritur sipas SNK 39)	-
Rritja e lejimeve për humbje nga kreditë është njohur në fitim ose humbje gjatë vitit	205
Bilanci i lejimeve për humbje më 31 Dhjetor 2018	205

Riklasifikimi përgjatë kalimit në SNRF 9 si rezultat i zbatimit të modelit të rrezikut kreditorë të pritur ishte jo material.

Shoqëria është eksposuar gjithashtu ndaj rrezikut kreditor lidhur me investimet e borxhit të cilat maten me vlerë të tregut nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Ekspozimi maksimal në fund të periudhës raportuese është vlera bartëse e këtyre investimeve.

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Obligacionet e korporatave	149,019	118,293
Obligacionet qeveritare	245,354	313,477
Bonot e thesarit	-	
GJITHSEJ	394,373	431,770

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur struktura e portofolit sipas klasifikimit:

Klasifikimi	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
A	53,915	55,514
BBB-BB	22,919	115,498
E pa klasifikuar	320,534	266,559
GJITHSEJ	397,368	437,571

FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

(Vlerat në Euro, përvèç nëse theksohet ndryshe)

16. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdimi):

Rreziku i normës së interesit

Tabela në vazhdim analizon pasuritë dhe detyrimet e Fondit në grupime relevante të maturimit duke u bazuar në periudhën e mbetur në datën e pozicionit financiar deri në datën e maturimit të kontraktuar, për 31 Dhjetor 2018 dhe 2017:

31 Dhjetor 2018	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 12 muaj	Që bartin interes			Gjithsej
			Nga 1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Që nuk bartin interes	
Pasuritë						
Paraja dhe ekuivalentët e saj	19,954	-	-	-	-	19,954
FVOCl	-	118,165	121,275	157,928	-	397,368
Të arkëtueshmet	-	-	-	-	14,926	14,926
Gjithsej Pasuritë Financiare	19,954	118,165	121,275	157,928	14,926	432,248
Llogaritë e pagueshme tregtare	-	-	-	-	(7,704)	(7,704)
Detyrimet ndaj lizingut	(229)	-	-	-	-	(229)
Gjithsej Detyrimet Financiare	(229)	-	-	-	(7,704)	(7,933)
Hendeku në neto riskun e interesit	19,725	118,165	121,275	157,928	7,222	424,315

31 Dhjetor 2017	Më pak se 1 muaj	Nga 1 në 12 muaj	Që bartin interes			Gjithsej
			Nga 1 në 5 vite	Mbi 5 vite	Që nuk bartin interes	
Pasuritë						
Paraja dhe ekuivalentët e saj	56,643	-	-	-	-	56,643
FVOCl	-	240,166	106,633	84,972	5,800	437,571
Të arkëtueshmet	-	-	-	-	25,307	25,307
Gjithsej Pasuritë Financiare	56,643	240,166	106,633	84,972	31,107	519,521
Llogaritë e pagueshme tregtare	-	-	-	-	(13,000)	(13,000)
Detyrimet ndaj lizingut	(299)	(2,749)	(632)	-	-	(3,680)
Gjithsej Detyrimet Financiare	(299)	(2,749)	(632)	-	(13,000)	(16,680)
Hendeku në neto riskun e interesit	56,344	237,417	106,001	84,972	18,107	502,841

Rreziku i monedhës së huaj

Shoqëria nuk është e eksposuar ndaj rrezikut të monedhës së huaj, pasi që të gjitha transaksionet e saj kryhen në monedhën vendase.

Rreziku i likuiditetit

Politika e Shoqërisë është që të investojë pasuritë në instrumentet e larta likuide financiare në tregje të ndryshme kapitale, në përputhshmëri me kufizimet e përkruara nga Ligji dhe Rregulloret. Gjatë procesit të krijimit të portofolit të Shoqërisë, me qëllim të sigurimit të likuiditetit sa më të lartë, pasuritë e Shoqërisë janë investuar në letra me vlerë të karakterizuara me mundësinë e këmbimit të shpejtë në para dhe ekuivalentë të saj. Tabelat në vazhdim analizojnë pasuritë dhe detyrimet e Shoqërisë në maturim përkatës, duke u bazuar në periudhën e mbetur në datën e bilancit të gjendjes deri në datën e kontraktuar të maturimit (në Euro).

FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIJA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

31 Dhjetor 2018	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Gjithsej
Pasuria					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	19,954	-	-		19,954
FVOCI	-	118,165	121,275	157,928	397,368
Të arkëtueshmet	14,926	-	-		14,926
Gjithsej Pasuritë Financiare	34,880	118,165	121,275	157,928	432,248
Detyrimet					
Llogaritë e pagueshme tregtare	(7,704)	-	-	-	(7,704)
Detyrimet ndaj lizingut	(229)	-	-	-	(229)
Gjithsej Detyrimet Financiare	(7,933)	-	-	-	(7,933)
Hendeku neto i likuiditetit	26,950	118,165	121,275	157,928	424,318
31 Dhjetor 2017	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Gjithsej
Pasuritë					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	56,643	-	-	-	56,643
Pasuritë financiare në dispozicion për shitje	-	243,886	107,893	85,792	437,571
Të arkëtueshmet	-	25,307	-	-	25,307
Gjithsej Pasuritë Financiare	56,643	269,193	107,893	85,792	519,521
Detyrimet					
Llogaritë e pagueshme tregtare	-	(13,000)	-	-	(13,000)
Detyrimet ndaj lizingut	(299)	(2,749)	(632)	-	(3,680)
Gjithsej Detyrimet Financiare	(299)	(15,749)	(632)	-	(16,680)
Hendeku neto i likuiditetit	56,344	253,444	107,261	85,792	502,841

17. Vlera e drejtë

Vlera e drejtë përfaqëson shumën me të cilën një pasuri mund të zëvendësohet, ose një detyrim të shlyhet në një transaksion duar lirë. Vlera e drejtë është bazuar në supozimet e menaxhmentit, sipas fitimit të pasurisë dhe bazës së detyrimit.

Instrumentet financiare të prezantuara me vlerë të drejtë

Pasuritë financiare të llogaritura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit finanziar në përputhshmëri me hierarkinë e vlerës së drejtë janë të paraqitura në tabelën vijuese. Kjo hierarki në Shoqëri mbledh pasuritë financiare dhe detyrimet në tri nivele të cilat bazohen në rëndësinë e të dhënave të ardhura, të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të pasurive financiare:

- Niveli 1:** çmimet e kuotuara (jo të rregulluara) në tregjet aktive për pasuritë identike ose detyrimet;
- Niveli 2:** të dhënat hyrëse të tjera, përveç çmimeve të kuotuara, të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë të gatshme për vëzhgim të pasurisë ose të detyrimit, në mënyrë direkte (p.sh. Çmimet) ose indirekte (p.sh. të bëra nga çmimet) dhe;
- Niveli 3:** të dhënat hyrëse në pasuri ose detyrim të cilat nuk bazohen në të dhëna të gatshme për vëzhgim të tregut.

Pasuritë financiare të cilat maten me vlerën e drejtë në pasqyrën e neto pasurisë së Fondit 1, janë grupuar sipas nivelit hierarkik të vlerës së drejtë, si në vazhdim (në Euro).

31 Dhjetor 2018	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Pasuritë	171,148	226,220	-	397,368
FVOCI	171,148	226,220	-	397,368

FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

(Vlerat në Euro, përvèç nëse theksohet ndryshe)

	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
31 Dhjetor 2017				
Pasuritë	437,571	-	-	437,571
Të Gatshme për Shitje	437,571	-	-	437,571

Tabela në vijim përmblehdh vlerat bartëse dhe vlerat e drejta të atyre pasurive dhe detyrimeve financiare të cilat nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tyre të drejtë.

	Vlera bartëse		Vlera e tregut	
	2018	2017	2018	2017
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentët e saj	19,954	56,574	19,950	56,574
Të arkëtueshmet	14,926	25,307	14,926	25,307
Gjithsej Pasuritë	34,880	81,881	34,880	81,881

Detyrimet

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe detyrimet ndaj lizingut	7,933	7,933	7,933	7,933
Gjithsej Detyrimet	7,933	7,933	7,933	7,933

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara në tregje aktive (sic janë letrat me vlerë të tregtueshme dhe në dispozicion për shitje) është e bazuar në çmimet e kuotuara të tregut në datën e pozicionit. Çmimi i kuotuar i tregut i përdorur për pasuritë financiare të mbajtura nga Shoqëria është çmimi aktual i ofertimit.

Vlera reale e instrumenteve financiare që nuk janë tregtuar në tregje aktive është përcaktuar duke përdorur teknikat e vlerësimit.

Vlera bartëse minus provizioni për dëmtimin e të arkëtueshmeve tregtare si dhe vlera bartëse e të pagueshmeve supozohet se përafrojnë vlerat e tyre reale. Vlera reale e detyrimeve financiare për qëllime të shpalosjes është vlerësuar duke zbritur rrjedhat e ardhshme të parasë së kontraktuar në normën e interesit aktual në treg që është në dispozicion të Shoqërisë për instrumente të ngjashme financiare. Megjithatë, për vendosjet bankare afatshkurta, ku normat e interesit janë të krahasueshme në treg, vlera kontabël është konsideruar të jetë përafriimi më i mirë e vlerës së drejtë.

18. Kontigencat dhe angazhimet

Çështjet gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2018 nuk është llogaritur provizion për humbjet e mundshme të ndërlidhura me çështje gjyqësore. Menaxhmenti i Shoqërisë rregullisht analizon rreziqet potenciale të cilat rezultojnë nga humbjet në lidhje me seancat gjyqësore dhe pretendimet e mundshme me synim kundër Shoqërisë, të cilat mund të dalin në të ardhmen. Edhe pse rezultatet e këtyre çështjeve nuk mund të përcaktohen gjithmonë me saktësi, menaxhmenti i Shoqërisë beson se nuk ka gjasa që të rezultojnë detyrime materiale.

Zotimet operative të qirasë

Më 31 Dhjetor 2018 është një marrëveshje e qirasë për objekte biznesore. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur detyrimet ndaj qirasë më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Brenda një viti	5,886	5,886
Mbi një vit	1,472	7,358
GJITHSEJ PËRGJEGJËSITË	7,358	13,244

19. Ngjarjet pas datës së raportimit

Pas 31 Dhjetorit 2018, datës së raportimit deri në miratimin e këtyre raporteve financiare, nuk ka ngjarje pasuese në pasqyrat financiare ose raste që janë materialisht të rëndësishme për shpalosjen e këtyre pasqyrave financiare.